



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 580 Akti

Nr. 406 Vendimi
Tiranë, më 24.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Suela Zhegu	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI TË RIVLERËSIMIT: Z. Federik Laloshi, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“, neni 64, pika 1, germa “a”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Me shkresën nr. **** prot., datë 9.6.2021, i është njoftuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit vendimi nr. ****, datë 16.7.2018, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë me anë të të cilit është deklaruar mbarimi i statusit të magjistratit, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, z. Federik Laloshi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

2. Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti, datës të botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016.
3. Në datën 25.10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese dhe, për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë deri më 19.1.2017. Gjykata Kushtetuese në datën 18.1.2017, rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit dhe ky vendim u botua në Fletore Zyrtare më 19.1.2017 dhe, si rezultat, afati 30-ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin ka përfunduar në datën 31.1.2017.
4. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për z. Federik Laloshi, me funksion prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka filluar menjëherë me:
 - a) plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016, në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
 - b) plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
 - c) plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.
5. Trupi gjykues i shortuar për këtë qëllim është i përbërë nga komisionerët: Etleda Çiftja, Alma Faskaj dhe Suela Zhegu.
6. Me vendimin nr. 1, datë 20.6.2020, trupi gjykues shprehu mospasjen e konfliktit të interesit, si dhe caktoi kryesuesin e tij.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

7. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
8. Pika 3 e nenit 179/b të Kushtetutës parashikon se: *“Procesit të rivlerësimit i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke iu nënshtuar ex officio”.*
9. Trupi gjykues ka konstatuar se z. Federik Laloshi ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
10. Me vendimin nr. ****, datë 16.7.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Federik Laloshi, me detyrë Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 19.7.2019, për shkak të plotësimit të moshës për dalje në pension. Me shkresën nr. ****prot., datë 14.12.2020, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Komisioni informohet se prej muajit korrik të vitit 2019, z. Federik Laloshi përfiton pension pleqërie. Sa më sipër, rezulton se ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk është ushtuar ankim.
11. Trupi gjykues çmon se objekti për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit apo qëllimi i këtij procesi, është bërë i pamundur referuar nenit 95, “Pamundësia në objekt apo qëllim”, të Kodit të Procedurës Administrative, i cili specifikon se: *“Organi publik deklaron të*

përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

12. Ligji nr. 84/2016, në pikën 6, të nenit 4, parashikon se kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në germën “c”, pika1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016.

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Federik Laloshi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.
2. Ky vendim u njoftohet, z. Federik Laloshi, Komisionerit Publik, si dhe vëzhguesve ndërkombëtarë.
3. Ankimi kundër këtij vendimi bëhet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 24.6.2021.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Etleda ÇIFTJA

Kryesues

Suela Zhegu

Anëtar

Alma FASKAJ

Relatore

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta